VENDIM
Nr.299, datë 3.5.2010

PËR NGRITJEN E GRUPEVE TË PUNËS PËR EVIDENTIMIN, VLERËSIMIN DHE RIVLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT DHE PËRMBYTJET E KOHËVE TË FUNDIT NË QARKUN E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", dhe të shkronjës "dh" të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ngritjen e grupeve të punës për evidentimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe përmbytjet e kohëve të fundit në qarkun e Shkodrës, në komunat Ana e Malit, Dajç, Bërdicë, Bushat, Gur i Zi, Velipojë, si dhe në bashkinë Shkodër.

2.Grupet e punës, sipas komunave dhe bashkisë Shkodër, të kenë në përbërje specialistë, të përcaktuar nga ministritë dhe institucionet e mëposhtme:

-Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, 14 veta;
-Ministria e Brendshme, 7 veta;
-Këshilli i qarkut të Shkodrës, 7 veta;
-Komunat dhe bashkia Shkodër, të prekura nga përmbytja, nga 1 specialist secila.

3.Grupet e punës të drejtohen nga përfaqësues të këshillit të qarkut të Shkodrës.

4.Emrat e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të këshillit të qarkut të Shkodrës për grupet e punës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, t'i dërgohen brenda 2 (dy) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, Ministrisë së Brendshme.

5.Kryerja e evidentimit, vlerësimit dhe rivlerësimit të dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore për blegtorinë të bëhet sipas formularit tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6.Formularët e plotësuar nga grupet e punës për evidentimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e dëmeve, së bashku me listën emërore të pronarëve të ekonomive bujqësore, shoqëruar me certifikatën e kryefamiljarit dhe fotokopjen e dokumentit të identifikimit, t'i dërgohen, nga këshilli i qarkut të Shkodrës, brenda 7 (shtatë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministrisë së Brendshme, pas miratimit nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet përkatëse, sipas fushave të veprimtarisë që ato mbulojnë.

7.Ministria e Brendshme paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave vlerën e dëmeve të shkaktuara nga përmbytja, së bashku me listën emërore të kryefamiljarëve të dëmtuar, të detajuar sipas objekteve të përcaktuara (kultura bujqësore, gjë e gjallë dhe bazë ushqimore), në përputhje me formularin tip të plotësuar, të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e institucionet përkatëse, sipas fushave të veprimtarive që ata mbulojnë dhe të dërguar nga këshilli i qarkut të Shkodrës.

8.Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në të mbjella, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.) të kryhet sipas çmimeve të tregut, të marra nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9.Efektet financiare të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe përmbytjet e kohëve të fundit në qarkun e Shkodrës të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

10.Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, prefekti i qarkut të Shkodrës dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

FORMULAR NR.3

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në bujqësi në qarqet Shkodër dhe Lezhë

Emri, mbiemri i fermerit_____
Fshati_____
Komuna_____
Qarku_____

I. Dëme të shkaktuara në kulturat bujqësore të arave

Nr.	Kulturat	Sipërf. e dëmtuar ha	Shkalla e dëmit në % ndaj sipërf, totale	Rend Kv/ha	Prodh. i dëmtuar Kv	Çmimi lekë/kv	Vlera e dëmit gjithsej lekë
1	Grurë			40		3000	
2	Lakër kokë			320		2500	
3	Qepë e njomë			200		5000	
4	Pras			280		4000	
5	Sallatë (në serë)			200		10 000	
6	Spinaq (në serë)			200		9000	
7	Jonxhë			400		600	
8	Foragjere të tjera (hasëll)			250		500	
	Shuma I						

II.Dëme të shkaktuara në pemë frutore, hardhi, ullinj

Nr.	Kultura	Njësia	Dëmtuar gjithsej rrënjë	Vlera lekë/rrënjë	Vlera lekë gjithsej
1	Pemë frutore të reja			4500	
2	Pemë frutore në prodhim të plotë			6000	
3	Ullinj të rinj			7800	
4	Ullinj në prodhim të plotë			12700	
5	Hardhi të reja			1250	
6	Hardhi në prodhim të plotë			1500	
	Shuma II				

III. Dëme të shkaktuara në kafshët bujqësore

Nr.	Lloji i kafshës	Njësia	Dëmtuar	Nr. i matrikullit	Vlera për	Vlera e dëmit

	(kategoria)		gjithsej	i gjedhit	kokë (lekë)	gjithsej (lekë)
1	Lopë race				140 000	
2	Lopë vendi				90 000	
3	Mushqerë				110 000	
4	Viça				40 000	
5	Dele				13 000	
6	Rrurëza (Milore)				8000	
7	Qengja				2500	
8	Dhi				12 000	
9	Ftuja				9000	
10	Keca				2500	
11	Dosa/Harça				25 000	
12	Derra				10 000	
13	Gica 0-3 muaj				4000	
14	Kali				45 000	
15	Pelë				65 000	
16	Mushkë				45 000	
17	Gomari				10 000	
18	Mëzi				10 000	
19	Pula fushe				1000	
20	Pula deti				3500	
21	Shpendë uji				1300	
22	Zogj				100	
23	Koshere blete				25 000	
	Shuma III					

IV.Dëme të shkaktuar në bazën ushqimore të blegtorisë

Nr.	Lloji i gjësë së gjallë	Nr. i krerëve	Nevoja për krerë				Vlera lekë
			Koncentrate		Të thata		
			Sasia kg/krerë	Çmimi lekë/kg	Sasia kg/krerë	Çmimi lekë/kg	
1	Gjedhe		270	26	900	23	
2	Të imta		27	26	180	23	
3	Derra		180	26	-	-	
4	Njëthundrakë		180	26	360	23	
5	Shpendë		10	26	-	-	
	Shuma IV						

SHUMA I+II+III+IV_____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1._____2._____3._____

4._____ Fermeri:_____

MIRATOHET

_____